



Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

Termat e Referencës për Workshopin për punëdhënësit (B.L 6.1)

Projekti “Aftësitë për Punësim të Qëndrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi - Aftësitë për Punë Shqipëri – Mali i Zi” Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020 nën Instrumentin për Asistencën së Para-Aderimit (IPA II).



Funded by
the European Union



BSC
B A R



AIDA
Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve



PËRMBAJTJA

1	INFORMACION I PËRGJITHSHËM	3
2	OBJEKTIVI, QËLLIMI & REZULTATET E PRITSHME	4
3	SUPOZIMET DHE RREZIQET	5
4	QËLLIMI I PUNËS	6
5	AFATI	7
6	MONITORIMI DHE VLERËSIMI.....	7



Funded by
the European Union



1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Vendi partner

Mali i Zi dhe Shqipëria

Autoriteti kontraktor

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Përshkrim i Projektit

Projekti “Aftësitë për Punësim të Qëndrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi - Aftësitë për Punë Shqipëri – Mali i Zi” Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020 nën Instrumentin për Asistencën së Para-Aderimit (IPA II), është zbatuar nga 3 organizata partnere:

1. **Business Start Up Center, Bar, Mali i Zi – Partner kryesor,**
2. **Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Tiranë, Shqipëri**
3. **Dhoma Ekonomike e Malit të Zi, Podgoricë, Mali i Zi,**

dhe partneri i lidhur

“Go2 Albania Shkodër, Shqipëri

Situata aktuale në sektor

Procesi i planifikimit të Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri filloi me identifikimin e sfidave kryesore në rajonin ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Malit të Zi. Analiza e përbashkët e problemeve sugjeroi perspektiva të dobëta punësimi për të rinjtë dhe gratë në rajonin kufitar, të cilat ose mbeten të papuna për shkak të mungesës së aftësive që përputhen me nevojat e tregut lokal të punës ose migrojnë nga pjesët më pak të zhvilluara në zonat më të zhvilluara të Malit të Zi dhe Shqipërisë ose jashtë saj. Kjo shoqërohet me mungesën e programeve më adekuate dhe të synuara të edukimit formal dhe joformal për të rinjtë dhe gratë dhe përdorimin e pamjaftueshëm të arsimit të dyfishtë që mund të rrisë aftësitë e punësimi që kërkohen në tregun e punës, por që duhet të paraprihen nga konsultime më të mëdha me punëdhënësit në rajonin CB. Situata është përkeqësuar më tej nga pandemia globale e Covid-19, e cila ka rezultuar me mbylljen e bizneseve SME-ve, humbjen e vendeve të punës dhe veçanërisht situatën e vështirë ekonomike në rajonet më pak të zhvilluara të Malit të Zi dhe Shqipërisë, gjë që kërkon ndërhyrje urgjente të kryera së bashku nga të gjithë aktorët përkatës në sektorin e zhvillimit të burimeve njerëzore, veçanërisht të rinjtë dhe gratë.



Funded by
the European Union



2 OBJEKTIVI, QËLLIMI & REZULTATET E PRITSHME

Objektivi i përgjithshëm

Objektivi kryesor i përgjithshëm i këtij projekti ka të bëjë me “Lehtësimin e aksesit në tregun e punës për të rinjtë dhe gratë në zonat ndërkufitare të Shqipërisë dhe Malit të Zi”.

Për të arritur objektivin e përgjithshëm/ndikimin e veprimit të propozuar, partnerët kanë zhvilluar një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin ndërtimin e aftësive për punësim dhe sipërmarrje të të rinjve dhe grave të papuna si grupi kryesor i synuar, por edhe ofrimin e mbështetjes së qëndrueshme për punëdhënësit në zonat ndërkufitare, të cilët janë aktorë kryesorë në trajtimin e sfidave të papunësisë. Duke pasur parasysh sektorët prioritarë të zhvillimit në zonat ndërkufitare (turizmi, TIK, hoteleria, bujqësia dhe sektorët e ndërlidhur), dhe në konsultim me punëdhënësit dhe palët e tjera të interesuara, kontributi në Ndikimin e Veprimit të propozuar do të arrihet përmes tre Objektivave Specifikë/ Rezultatet: OC1: Rritja e aftësive dhe kompetencave profesionale të të rinjve dhe grave të papuna në rajonin ndërkufitar për të përmbushur kërkesat e punësimit në sektorin e turizmit, TIK-ut dhe mikpritjes; OC2: Zhvillimi i aftësive të vetëpunësimit / sipërmarrjes - planifikimi strategjik, rrjetëzimi, marketingu dhe shitjet, e-biznesi - midis të rinjve dhe grave në rajonin ndërkufitar në fushën e TIK-ut, turizmit, mikpritjes, gastronomisë dhe zejeve tradicionale; dhe OC3: Krijimi i një marke ndërkufitare për promovimin e produkteve dhe shërbimeve vendase, me qëllim përmirësimin e konkurrencës, vetëpunësimit, parakushteve për punësim të mëtejshëm dhe rritjes së bashkëpunimit ndërkufitar nga biznesi në sektorët prioritarë në rajonin e zonave ndërkufitare Shqipëri- Mal i Zi. Objektivat/Rezultatet specifike të Veprimit pasqyrojnë një qasje të integruar dhe me shumë nivele të bazuar në tre shtylla të ndërlidhura: 1) Program trajnimi teorik dhe praktik (në vendin e punës) për punëkërkuessit e përzgjedhur për të rritur aftësitë e kërkuara të punësimit në sektorët përkatës të identifikuar në zona ndërkufitare; 2) Një program gjithëpërfshirës trajnimi dhe mentorimi që stimulon vetëpunësimin për të rinjtë dhe gratë e përzgjedhura që dëshirojnë të fillojnë bizneset e tyre në zonën ndërkufitare; dhe 3) Mbështetje e qëndrueshme dhe për punëdhënësit në zonën e ndërkufitare për të përmirësuar konkurrencën dhe për të krijuar vende pune për të nxitur punësimin në rajonin kufitar. Këto tre shtylla do të mbështeten dhe plotësohen shtesë nga aktivitetet e projektit, shpërndarja e rezultateve dhe mbështetja e këshillimit/shkëmbimit të përvojës përmes krijimit të mjeteve online dhe komunikimit. Si komponenti promovues ashtu edhe programi i mbështetjes gjithëpërfshirëse bazuar në nevojat e punëkërkuessve dhe punëdhënëssve pritet të kontribuojnë në treguesit e Programit: Veprimi i propozuar parashikon që të përfitojnë minimalisht 70 të rinj dhe gra të papunë nga programi (trajnim dhe mentorim). në drejtim të rritjes së aftësive të tyre për punësim, dhe të paktën 25% e tyre pritet të gjejnë punë.



Funded by
the European Union



Qëllimi

Qëllimi i kësaj kontrate është si më poshtë:

Punëdhënësit në rajonin ndërkufitar Shqipëri – Mal i Zi do të luajnë një rol vendimtar në rritjen e punësimit të grupeve të synuara të projektit dhe 30 punëdhënës – 15 nga Mali i Zi dhe 15 nga Shqipëria do të identifikohen për të kryer trajnime në vendin e punës për një kohëzgjatje prej tre muajsh, për të cilat ata do të marrin trajnime dhe udhëzime nga trajnerët e angazhuar në projekt.

Rezultatet e pritshme

- Zhvillimi i një Workshopi për punëdhënësit e organizuar në Shqipëri;
- 15 pjesëmarrës të trajnuar për trajnim në punë;
- Hartimi i një Udhëzuesi për trajnimet në punë që do të mbulojë hapat për trajnimin në punë, formularët dhe raportet që duhet të plotësohen nga trajneri në punë dhe nga pjesëmarrësi.

3 SUPOZIMET DHE RREZIQET

Supozimet e projektit

- Eksperti, AIDA, si dhe organizatat partnere, do të bashkëpunojnë ngushtë për drejt shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira të biznesit.
- Projekti do të zbatohet me sukses pavarësisht kompleksitetit të tij.

Rreziqet

- Rreziqet që lidhen me pasojat post COVID-19
- Kompleksiteti i komunikimit dhe koordinimit, keqkuptime të mundshme

Shtyrja e aktiviteteve;

- Anulimet nga pjesëmarrësit
- Akses i dobët në pjesëmarrje për individët që banojnë jashtë vendndodhjes së trajnimit



4 QËLLIMI I PUNËS

Të Përgjithshme

4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Organizimi i një workshopi për mentorët/ punëdhënësit në Shqipëri. Eksperti do të trajnojë 10 mentorët për trajnimin në punë të pjesëmarrësve. Punëdhënësit do të trajnohen për t'u bërë mentorë dhe për të ofruar trajnim cilësor në punë për 15 pjesëmarrësit.

Eksperti do të:

1. Të përgatisë një material/guide me informacione të nevojshme për mentorët, të këshilluar me parë me AIDA-n dhe organizatat partnere, për realizimin e workshopit 1 (një) ditor me 10 mentorët. Gjatë workshopit do të diskutohet rreth nevojave që punëdhënësit kanë në punë dhe përcjelljen e tyre tek individët që do të trajnohen me qëllim të fitojnë aftësi të reja për punë dhe të integrohen në tregun e punës;
2. Të jap udhëzime për trajnimin në punë që do të përfshijë të paktën kohëzgjatjen, detyrat dhe fushat që do të mbulohen, pikat që duhen arritur dhe monitoruar;
3. Të hartojë dhe përgatisë modele raportimi/time sheet që do përdoren në vijim nga mentorët për të raportuar mbi ecurinë e të trajnuarëve në vendin e punës (duke saktësuar elemente që lidhen me kohën e shpenzuar, efektivitetin e trajnimit dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme në procesin e trajnimit).

4.1.2. Zona gjeografike e projektit

Mali i Zi dhe Shqipëria

4.1.3. Grupet e synuara

Grupi kryesor i synuar për këtë aktivitet janë punëdhënësit në zonën ndërkufitare Shqipëri- Mal i Zi. Megjithatë, të rinjtë dhe gratë do të jenë përfituesit përfundimtarë sepse me trajnimin në punë do të përfitojnë nga rritja e aftësive të tyre.

4.1.4. Punë specifike

Eksperti do të jap udhëzime për trajnimin në punë që do të përfshijë të paktën:

1. Përshkrimin e trajnimit në vendin e punës (kohëzgjatja, detyrat dhe fushat që do të mbulohen, pikat që duhen arritur dhe monitoruar).
2. Formularët që duhet të plotësohen dhe të dorëzohen pranë AIDA-s për të verifikuar punën e kryer nga punëdhënësit. Këto forma përfshijnë punën e kryer dhe vlerësimin e rritjes së aftësive të pjesëmarrësve.



Funded by
the European Union



3. Formularët që duhet të plotësohen nga të trajnuarit – të rinjtë dhe gratë që marrin pjesë në trajnimin në vendin e punës që përfshijnë të paktën: fletë kohore/timesheet dhe vetëvlerësimin.

Menaxhimi i projektit

Institucioni përgjegjës për Shqipërinë

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

5 AFATI

Data e fillimit dhe periudha e zbatimit të detyrave

Data e parashikuar e fillimit është brenda muajit shtator 2023.

6 MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Përkufizimi i treguesve

- 1 Udhëzues për trajnimin në punë
- 1 Workshop i organizuar
- 10 pjesëmarrës në Workshop



Funded by
the European Union

